



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 14

Datë: 08. 05. 2019. Ora: 14:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë.

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ.

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Sami Hamiti, Adnan Rrustemi, Florian Dushi, Nazlije Bala, Ercan Spat, Alfred Kinolli, Čemajli Kurtiši.

SKQZ: Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ. Valmira Selmani, u.d. ZRPPC.

Përkthyes: Vera Dula. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

-Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së KQZ-së nr. 12 dhe 13 /2019

2. Aktivitetet e ZRPPC-së:

- Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për çregjistrimin e katër (4) Partive Politike;
- Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për shfuqizimin e Pezullimit të tri (3) Partive Politike;

3. Këshilli për Cështje Ligjore

4. Këshilli Mbikëqyrës për Informim Publik:

- Shqyrtimi dhe miratimi i tingullit;
- Shqyrtimi dhe miratimi i logos dhe sloganit;
- Shqyrtimi dhe miratimi i dizajnit;

5. Të ndryshme.

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

Valdete Daka: A kemi ndonjë propozim, vërejtje...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës pa vërejtje, propozime etj.

Në vazhdim të mbledhjes, u miratuan edhe procesverbalet e mbledhjeve të KQZ-së, nr. 12 dhe numër 13 /2019.

2. Aktivitetet e ZRPPC-së

1. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për çregjistrimin e katër (4) Partive Politike:

Valmira Selmani, u.d. ZRPPC: Zyra ka përgatitur rekomandimin për çregjistrimin e katër (4) Partive Politike. Nga 9 parti që kanë qenë për pezullim me vendim të KQZ – së, më datën 2.03.2018, për mos dorëzim të të dhënave të ndryshuara vjetore, në përputhje me nenin 11 të Rregullës 01/ 2013 për Regjistrim dhe Veprim të partive Politike. Katër (4) Parti Politike, nuk i kanë përmbushur obligimet, as pas afatit që ka dhënë zyra. Bazuar në tejkalimin e afateve ligjore nga këto subjekte, zyra i rekomandon KQZ-së, çregjistrimin e këtyre partive:

- 1.** Partia e Ballit,
- 2.** Partia e Fortë,
- 3.** Aktivna Gragjanska Iniciativa,
- 4.** Savez Social demokrata.

Valdete Daka: A ka pyetje...?

Adnan Rrustemi: Bëhet fjalë për vendim të rëndësishëm...Është një afat 45 ditë, pas pezullimit...A është siguruar ky afat...?

Sami Hamiti: Ka kaluar një vit, tashmë...

Anëtarët e KQZ-së, me votim të veçuar, c ‘regjistruan këto katër parti.

Valdete Daka: Të njoftohen përfaqësuesit e këtyre partive, të bëhet publikimi në ueb faqe i këtij vendimi, dhe natyrisht, këto subjekte kanë të drejtë ankese 24 orë pas vendimit të marrë...

2. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për shfuqizimin e Pezullimit të tri (3) Partive Politike:

Valmira Selmani, u.d. ZRPPC: Zyra, ka përgatitur rekomandimin për shfuqizimin e Pezullimit të tri (3) Partive Politike. KQZ, ka marrë vendim më datën 2.03.2018 që në afat shtesë prej 20 ditësh, ti dorëzojnë të dhënat e ndryshuara vjetore bazuar në nenin 6 sipas Rregullës 01/ 2013 për Regjistrim dhe Veprim të Partive Politike. Këto parti, kanë respektuar afatin ligjor:

1. Partia Demokratike e Unitetit.
2. Cernagorska Liberalna Stranka.

3. Nova Partija Kosova.

Pra, në afatin shtesë kanë dorëzuar azhurnimet, dhe ne rekomandojmë shfuqizimin e pezullimit për këto tri (3) parti.

Anëtarët e KQZ-së, me votim të veçuar, miratuan shfuqizimin e pezullimit për këto tri parti.

Valdete Daka: Në materialin e rekomanduar, janë edhe gjobat e shqiptuara. Rekomandimi i Zyres, është për shqiptim të gjobave. Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rekomandimin e zyrës për shqiptim të gjobave.

3.Këshilli për Cështje Ligjore

Adnan Rrustemi: Në cilësinë e zëvendësit të kryesuesit të këtij këshilli, ju informoj se në mbledhjen e fundit, Këshilli ka shqyrtuar një kërkesë për zëvendësim të anëtarit të Kuvendit Komunal në Komunën e Lipjanit. Bëhet fjalë për dorëheqjen e parevokueshme të z. Selatin Ratkoceri nga subjekti politik, Lëvizja “VETËVENDOSJE!”.

Në bazë të rregullativës, Alban Salihu, është në radhë për zëvendësim...Kërkesa është e kompletuar mbi bazë ligjore, dhe ne rekomandojmë për miratimin e këtij zëvendësimi.

Valdete Daka: Kush është që Alban Salihu nga subjekti politik, Lëvizja “VETËVENDOSJE!”, ta zëvendësoj z. Selatin Ratkocerin...?

4.Këshilli Mbikëqyrës për Informim Publik:

Nazlie Bala: Sot në takimin e 5-të të Këshillit për Informim Publik, i kemi shqyrtuar produktet të cilat kompania i ka ofruar: 1. Tingullin. Logon dhe sloganin. 3. Dizajnin. Prandaj, si këshill, ne rekomandojmë për aprovim të KQZ-së të këtyre produkteve. Në kontekst, kompania operuese për informim publik, e ka bërë demonstrimin e këtyre produkteve para anëtarëve të KQZ-së, të cilët edhe i kanë shqyrtuar dhe analizuar, dhe pastaj i kanë aprovuar për editim dhe shërbim të votuesve...